

Nr.regj. 24899/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Bogoljub Staletović nga Graçanica, për kundërvajtje nga neni 6 paragrafi 2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195,199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë **12.12.2011** merr këtë:

AKTVE N D I M

I PANDEHURI: Bogoljub Dušan Staletović, i lindur më 12.03.1956 në fshatin Talinocv, tani jeton në Graçanicë, me shkollim superior, tani Zëvendës Avokat i Popullit, i martuar, babë i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepse, si Zyrtar i Lartë Publik, në pozitë të Zëvendësit të Kryeshefit të Sekretariatit të Këshillit Qendror Zgjedhor, nuk ka bërë deklarimin e rregullt vjetor të gjendjes së pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, deri më 31.03.2011,

-me veprim të tillë ka kryer kundërvajtje nga neni 6 paragrafi 2 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej **400 € (katërqind euro)**, të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. Pagesa bëhet në ndonjë agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagesës së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **26 ditësh**, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumë prej **5 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtroi kësaj gjykate Kërkesën 01-3213/11 me datë 19.07.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, meqë i njëjti nuk e ka dorëzuar në Agjencinë Kundër Korrupsion formularin mbi deklarimin e rregullt të gjendjes së pasurisë deri më 31.03.2011.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloi procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se nuk e kishte bërë deklarimin e rregullt të pasurisë për vitin 2011 ngase nuk e kishte ditur se është i obliguar të bëjë një gjë të tillë për shkak se sipas një liste të cilën ia prezantoi gjykatës e në të cilën në mesin e pesë zyrtarëve të lartë të KQZ për vitin 2010, emri i tij fare nuk kishte qenë i shënuar. Në vazhdim i pandehuri thekson se diku në muajin korrik të vitit 2011 ai është interesuar për çështjen e deklarimit të pasurisë dhe ka konstatuar se zyrtarja e caktuar si pikë kontaktuese midis AKK dhe SKQZ iu kishte dërguar gjithë zyrtarëve të lartë të KQZ njoftimin dhe detajet tjera për deklarimin e pasurisë, mirëpo tek i pandehuri nuk kishte arritur ky njoftim meqë adresa elektronike në emër të tij kishte qenë e shkruar me gabim, për çka ofroi dëshmi të

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot _____
Dep. <u>D.P</u>	B: Prot _____
Dep. _____	Prot No <u>03-5151/11</u>
Nr. i faq _____	Data _____
Broj stranica _____	Datum <u>30.12.2011</u>
Nr. pages _____	Date _____
PRISHTINE	

korrespondencave elektronike. Përndryshe i pandehuri shton se në vitet e mëhershme kishte bërë deklarin e pasurisë, ndërsa siç thekson këtë vit ndoshta ka bërë gabim pse nuk është interesuar para datës 31 mars, por nuk ka pasur për qëllim të shmangët nga deklarimi i pasurisë meqë edhe pas përfundimit të punës në KQZ dhe pas marrjes së detyrës së re në zyrë të Zëvendësit të Avokatit të Popullit kishte deklaruar pasurinë, për çka edhe i prezanton gjykatës dëshmitë.

Për të vërtetuar gjendjen e plotë dhe të drejtë faktike, gjyqtarja ftoi edhe zyrtaren e KQZ e cila ka qenë pikë kontaktuese midis KQZ dhe AKK, në cilësi të dëshmitares, e cila deklaroi se listën me pesë emra të zyrtarëve të lartë të KQZ, i pandehuri nuk e kishte siguruar nga KQZ, ajo listë mbante një llogo të AKK e jo të KQZ, i përkiste vitit 2010 dhe ishte thjeshtë e panënshkruar dhe e paprtokoluar, andaj nuk mund të jetë obligative për asnjëri. Në vazhdimi dëshmitarja sqaron se në adresë të njëjtë elektronike ia kishte dërguar të pandehurit njoftimin për qëllim deklarimi të pasurisë edhe vitin e kaluar dhe nuk kishte pasur asnjë mosmarrëveshje, ndërsa këtë vit, i pandehuri apo çdo person tjetër i interesuar për ndryshim adrese elektronike është dashur të lajmërohet para datës 31 mars, përndryshe dëshmitarja sqaron se listën me emra dhe adresa elektronike të zyrtarëve të lartë mund ta pasurojë çdo vit me emra të rinj, ndërsa adresat e mëhershme i korrigjon vetëm me iniciativë të vet të interesuarve.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit, shqyrtimi i provave materiale dhe shkresave të tjera të lëndës, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë faktike, ekzistimin e veprës kundërvajtëse dhe përgjegjësisë së të pandehurit për këtë kundërvajtje, meqë i pandehuri nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë me kohë, pavarësisht se nuk ka pasur për qëllim shmangien nga obligimi, por thjeshtë për shkak se e ka neglizhuar çështjen e deklarimit të pasurisë. I njëjti duke mbajtur pozitën e dytë në KQZ është dashur të dijë se sikur edhe vitin e mëhershëm sërish duhej të ketë obligimin e njëjtë të deklarimit të pasurisë, andaj edhe është dashur të interesohet me kohë, ndërsa deklarimin e pasurisë me përfundimin e detyrës dhe marrjen e detyrës së re, gjyqtarja e konsideroi si rrethanë lehtësuese, andaj duke i vlerësuar gjitha provat veç e veç dhe gjitha së bashku, të pandehurin dënoi me dënimin e paraparë ligjor.

Gjatë shqiptimit të dënimit gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe duke vlerësuar masën e shkeljes sipas pozitës së zyrtarit të lartë publik si dhe personalitetin e tij, të njëjtit ia shqiptoi dënimin me gjobë të precizuar si në dispozitiv, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmangët nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr.regj.24899/2011 datë 12.12.2011

Gjyqtarja
Suzana Cerkini

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimit të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.